

**VENDIM**  
**Nr. 402, datë 19.6.2024**

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË TË NEGOCIOJË  
DREJTPËRDREJT ME SUBJEKTIN NDËRKOMBËTAR G37 CHAMBERS, PËR  
OFRIMIN E SHËRBIMIT TË KONSULENCËS PËR ANALIZIMIN DHE  
VLERËSIMIN E TË DHËNAVE QË DUHET TË MBLIDHEN NGA MINISTRIA E  
DREJTËSISË, ME QËLLIM VLERËSIMIN E FUSHAVE TË REKOMANDIMEVE  
PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT DHE PËR HARTIMIN  
E METODOLOGJISË PËR MËNYRËN E VLERËSIMIT E TË NDJEKJES NË  
VAZHDIMËSI TË ZBATIMIT TË KËTYRE REKOMANDIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, ‘Për prokurimin publik’”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autorizimin e ministrit të Drejtësisë të negociojë drejtpërdrejt me subjektin ndërkombëtar G37 Chambers për ofrimin e shërbimit të konsulencës, për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave që duhet të mblidhen nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim vlerësimin e fushave të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe për hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të këtyre rekomandimeve.

2. Negociimi të ketë në objekt:

a) identifikimin dhe analizimin e situatës aktuale të fushave kryesore që lidhen me luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve, si dhe garantimin e të drejtave e të lirive themelore të qytetarëve, në kuadër të rekomandimeve prioritare;

b) identifikimin dhe analizimin e situatës aktuale mbi politikën penale të ndjekur deri më tani, me fokus krimin e organizuar e antikorrupsionin dhe tendencat e kriminalitetit në vend, duke dhënë edhe rekomandime për vendimmarrjen e ardhshme për politikën penale;

c) evidentimin, marrjen dhe analizimin e të dhënave për vlerësimin e rekomandimeve të dhëna në luftën kundër kriminalitetit, si dhe për vlerësimin e politikës penale, që duhet të hartojë Ministria e Drejtësisë në përmbushje të detyrimit ligjor;

ç) identifikimin e kritereve të qarta dhe të matshme, të cilat do të shërbejnë si një pikënisje për daljen në konkluzione për rekomandimet që duhet të jepen, bazuar në vlerësimin e problematikave dhe gjetjeve mbi tendencat e kriminalitetit në vend, me fokus krimin e organizuar dhe antikorrupsionin në kategori të ndryshme të marrëdhënieve shoqërore që mbrohen nga Kodi Penal;

d) përgatitjen e formateve tip, platformave apo mjeteve/formave të tjera për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit mbi tendencën e kriminalitetit, si dhe mënyrën e zbatimit të rekomandimeve prioritare të cilat do të duhet të identifikohen nga këto të dhëna;

dh) identifikimin e fushave dhe çështjeve që duhet të shërbejnë si bazë në përgatitjen e rekomandimeve prioritare të ardhshme të Këshillit të Ministrave;

e) hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe paraqitjen e saj për miratim pranë ministrit të Drejtësisë.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**

**Edi Rama**